



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

30.01.2017

Senati i Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” në përputhje me Statutin në fuqi dhe Rregulloren për të ardhurat personale, në mbledhjen e mbajtur me datë 19.1.2017, në bazë të nevojave të njëjësive akademike, vendosi që të shpall:

Konkurs

për angazhimin me honorar të personelit akademik për semestrin veror të vitit akademik
2016/2017

Fakulteti i Gjeoshkencave

1. Një mësimdhënës për lëndët: Praktika industrial dhe Materialet zjarrduruese

Kushtet e përgjithshme për angazhim:

Angazhimi me honorar i personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat Statutit në fuqi dhe Rregullores për të ardhura personale të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”, Ligjit për arsimin e lartë dhe Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës nr. 03-L-212.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

Të gjithë kandidatët që paraqitur në konkurs duhet të sjellin këto dokumente:

- Kërkesën me CV;
- Kopjen e diplomës përkatëse të noterizuar te organi kompetent;
- Kandidatët që kanë doktoruar, magjistruar, kanë mbaruar master jashtë vendit apo studimet themelore, duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.
- Kandidatët, të cilët kanë punuar në institucionet e arsimit të lartë – vendimin për zgjedhjen e fundit,
- Dëshmi për punimet shkencore, monografive, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj.
- Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie në ndonjë institucion të akredituar të Arsimit të Lartë.

Dorëzimi i dokumenteve bëhet në Fakultetin e Gjeoshkencave nga data 30.01.2017 deri më 07.02.2017 prej orës 8.00-16.00. Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike. Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pa kompletuara nuk do të merren në shqyrtim. Konkursin mund ta gjeni të publikuar në: www.umib.net

Për informata më të hollësishe mund të kontaktoni administratën e fakulteteve përkatëse në këta numra telefoni: Fakulteti i Gjeoshkencave: +381(0)28530446, prej orës 08:00 – 16:00.

